



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-29636/26
Klinë, datë: 10.09.26

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i nëntë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e Komunes së Klinës (te rinjet dhe grat) tema prioritetet e grave dhe te rinjeve te komunës së Klinës, me, datë 03.09.2026, ora 16:00 Vendi, Salla e Kofewrncave Komuna Klinës Kati III.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emailin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-29636/26

Klinë, datë: 10.09.26

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i nëntë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e Komunes së Klinës (te rinjet dhe grat) tema prioritetet e grave dhe te rinjeve te komunës së Klinës, me, datë 03.09.2026, ora 16:00 Vendi, Salla e Kofewrncave Komuna Klinës Kati III.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit

dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 16:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te komunës së Klinës.

Nga qytetarët morën pjesë 5 persona, prej të cilëve, 5 gra,

Shtojca 9 – Fotografi nga dëgjim i nëntë për kornizën afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me te Rinjet dhe Grat e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

Përshëndetje të gjithëve dhe mirë se keni ardhur.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim. Sot po e mbajmë dëgjimin e nëntë me radhë, ku po e prezantojmë draft-buxhetin e Komunës për vitin 2027.

Këto dëgjime janë të rëndësishme për ne, sepse na japin mundësinë që të dëgjojmë drejtpërdrejt qytetarët, kërkesat e tyre dhe idetë që kanë për zhvillimin e komunës sonë. Sot tema jonë është “Prioritetet e grave dhe të rinjve në komunën tonë”.

Ne besojmë se gratë dhe të rinjtë janë një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të komunës. Prandaj, në planifikimin e buxhetit për vitin 2027, duam që nevojat dhe kërkesat e tyre të jenë pjesë e rëndësishme e projekteve dhe investimeve tona.

Për të rinjtë, synimi ynë është të krijojmë më shumë mundësi për arsimim, trajnime, punësim, zhvillim profesional, sport, kulturë dhe aktivitete të tjera që u japin mundësi të rinjve të zhvillohen dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre këtu.

Duam që të rinjtë të kenë më shumë hapësira dhe mundësi për të treguar talentin dhe aftësitë e tyre. Po ashtu, duam që ata të jenë më të përfshirë në jetën e komunës dhe në vendimmarrje. një vëmendje e veçantë do t’u kushtohet edhe grave. Ne duam të krijojmë më shumë mundësi për gratë në punësim, në zhvillimin e bizneseve, në trajnime dhe në fuqizimin e tyre ekonomik, është e rëndësishme që gratë të kenë mundësi të jenë pjesë e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të komunës dhe të kenë mbështetjen e nevojshme për të realizuar idetë dhe potencialin e tyre. Draft-buxheti për vitin 2027 është një plan fillestar, i cili duhet të pasurohet edhe me kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve prandaj, sot nuk jemi vetëm për ta prezantuar buxhetin. Jemi këtu edhe për t’ju dëgjuar juve dua që gratë dhe të rinjtë të na tregojnë se cilat janë nevojat e tyre, cilat janë problemet që i hasin dhe çfarë projekteve mendojnë se duhet t’u japim përparësi gjatë vitit 2027 Çdo ide dhe çdo sugjerim është i rëndësishëm për ne qëllimi ynë është që buxheti i vitit 2027 të jetë sa më afër nevojave të qytetarëve dhe që investimet tona të sjellin mundësi dhe zhvillim për të gjithë. Prandaj, ju falënderoj edhe një herë për pjesëmarrjen dhe ju ftoj që të jeni sa më të hapur me propozimet dhe kërkesat tuaja.

Diskutimet e pjesëmarrësve

Majlinda Morina, Klinë

Kërkesa ime është që kam plan të hap një biznes privat dhe dëshiroj të di nëse ka mundësi që Komuna të më ndihmojë në blerjen e pajisjeve të nevojshme

Pergjigja e Kryetarit:

Faleiminderit Majlinda, Ne edhe më herët kemi mbështetur bizneset e reja përmes programit Start-Up, duke ndihmuar qytetarët që të fillojnë bizneset e tyre. Për momentin kemi disa vështirësi me buxhetin, sidomos për shkak të obligimeve financiare që rrjedhin nga kontrata kolektive. Megjithatë, ne do të mundohemi që përsëri, përmes ndonjë programi apo forme tjetër të mbështetjes, të krijojmë mundësi për t’i ndihmuar bizneset e reja në filli tyre

qëllimi ynë është që të mbështesim sa më shumë të rinjtë dhe qytetarët që kanë ide dhe dëshirë për të hapur një biznes.

Bete Gojani, Klinë

Kërkesa ime është që një rrugicë e shkurtër në fshatin Radulloc të shtrohet me asfalt. Po ashtu, kërkoj që të zgjerohen kanalet e ujit dhe të ndërtohet një trotuar me ndriçim publik, së bashku me një shëtitore në fshatin Radulloc.

Pergjigja e Kryetarit:

Faleminderit për kërkesën tuaj. Ne do ta marrim me seriozitet dhe do ta shqyrtojmë si pjesë të prioritetëve t' do të planifikojmë që kjo rrugë të përfundojë në tërësi, duke përfshirë kanalizimin, trotuarin, ndriçimin publik dhe asfaltimin. Qëllimi ynë është që rruga të jetë e rregulluar dhe funksionale për të gjithë banorët e kësaj zone. Faleminderit për sugjerimin dhe për bashkëpunimin tuaj.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 16:40

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	5
Burra	0
Totali	5

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

